



AS  
620  
7-12-2022  
Lubiana

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE

Korçë, me 02.12.2022

**SHPLLJE VENDIMI**

Drejtuar : Njesise Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

Per: shtetasin : Ermir Terolli, me adrese fshati Zvezde,  
Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil  
nr. 778, dt. 10.11.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj  
njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e  
komunikimit eshte kthyer me shenimin: "Larguar" dhe pas  
afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule  
e firme, ne gjykate.

**KANCELARE**  
**Lubiana KINOLLI**

U afishua sot ne date -----  
Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.  
Nepunesi \_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)

Nr. 138 Prot

- Kuj. H. Pojan.  
2. Vek. gjyqesore  
OK 07.12.2022  
Lubiana

2

3

4

5





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË

Nr.Regj.Them. 21001-01267-41-2022(1230)  
Data e regjistrimit 12.09.2022

Nr. vendimi 41-2022-3423 (778)  
Datë vendimi 10.11.2022

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë e përbërë nga:

**GJYQTARE - Gentiana Shukullari**

asistuar prej sekretares gjyqësore Brilda Hoxhallari, në Korçë sot më datë 10.11.2022, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën civile me nr. regj. themel.21001-01267-41-2022 (1230), që i përket:

**PADITËSE:**

Shkendie Terolli e bija e Ylberit dhe Myneverit, e dtl. 26.02.1986, lindur dhe banuese në Baban, Njësia Administrative Hoçisht, bashkia Devoll, përfaqësuar nga av. Refat Agolli, anëtar i Dhomës së Avokatisë Korçë me nr. license 7897 dhe Nipt M16402601A.

**IPADITUR:**

Ermir Terolli i biri Vërgimthit dhe Alketës, i dtl. 01.05.1984, lindur dhe banues në Zvezdë, Njësia Administrative Pojan, bashkia Korçë.

**OBJEKTI:**

Zgjidhje martese. Rregullimi i pasojave.

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 132 i K.Familjes.

Në përfundim të gjykimit, i cili u zhvillua në mungesë të paditëses e të paditurit dhe në prani të përfaqësuesit të paditëses av. Refat Agolli, gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi provat e administruara dhe dëgjoji konkluzionet përfundimtare të përfaqësuesit të paditëses i cili kërkoi, pranimin e padisë dhe lënien e djalit Ergim Terolli për rritje dhe edukim paditëses,

**V Ë R E N:**

Pala paditëse Shkendie Terolli i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me padinë me objekt: *"Zgjidhje e martesës. Rregullimi i pasojave."*

Paraprakisht, gjykata konstatoi se kjo mosmarrëveshje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Korçë është kompetente nga pikpamja lëndore, bazuar në nenin 41 e 349 shkronja "a" e K. Pr. Civile, si dhe nga pikpamja tokësore, bazuar në nenin 51 të K. Pr. Civile, si gjykata ku kanë vendbanimin e fundit të përbashkët bashkëshortët.

***Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi e provuar se:***

Paditësja Shkëndie Terolli dhe i padituri Ermir Terolli janë njohur dhe kanë lidhur martesë ligjore në datën 10.11.2006 në ish komunën Pojan, referuar çertifikatës së martesës datë 4.08.2022, lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile (Arkiva) Korçë. Ata pas martesës, janë larguar për të jetuar në Greqi, ku janë vendosur në qytetin e Athinës. Referuar çertifikatës familjare datë 26.08.2022 Zyra e Gjëndjes Civile 247, Njësia Administrative Pojan, nga kjo martesë ka ardhur në jetë fëmija, Ergim Terolli i datëlindjes 10.12.2008. Fillimisht marrëdhëniet midis tyre kanë qënë të mira, por më pas kanë filluar grindjet dhe mosmarrëveshjet për shkak se i padituri ka filluar të konsumojë pije alkoolike. Për shkak të kësaj situatë e cila ka degraduar edhe në dhunë fizike ndaj saj, paditësja është larguar në vitin 2011 nga banesa bashkëshortore duke u kthyer në Shqipëri. Por më pas, i ka dhënë dhe një mundësi tjetër të paditur, për shkak edhe të fëmijës së tyre, duke filluar sërish bashkëjetesën me të në Greqi. Duke qënë se i padituri ka filluar sërish të konsumojë pije alkoolike dhe palët nuk mirëkuptoheshin më në marrëdhënien e tyre, paditësja është larguar nga banesa bashkëshortore. Pas veçimit, palët kanë ndërprerë çdo lloj marrëdhënie bashkëshortore, duke ruajtur komunikimin vetëm lidhur me djalin. Nisur nga sa më sipër, paditësja duke e parë të pamundur vijimin e martesës, i është drejtuar gjykatës me padi për zgjidhjen e saj.

Gjkata, bazuar në nenet 134 dhe 135 të Kodit të Familjes, zhvilloi seancën e pajtimit në të cilën dëgjoi të dy palët lidhur me marrëdhënien e bashkëjetesës së tyre dhe situatën në të cilën ndodhen. Gjatë kësaj seance, por dhe gjatë gjykimit, gjykata, bëri të gjitha përpjekjet për të realizuar pajtimin e palëve. Pasi dëgjoi të dy palët ndërgjyqëse, gjykata krijoi bindjen se midis tyre nuk ka mundësi për të realizuar pajtimin dhe në këto kushte, kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

***Pretendimet e paditëses.***

Nëpërmjet kërkesëpadisë dhe shpjegimeve të dhëna gjatë gjykimit, paditësja ka parashtruar se martesa me të paditurin e ka humbur qëllimin e saj. Ajo është shprehur se marrëdhëniet me të paditurin janë shoqëruar me grindje të vazhdueshme për shkak se ai konsumon rregullisht pije alkoolike. Megjithëse i ka dhënë disa mundësi të paditurit për të ndryshuar mënyrën e jetesës dhe të sjelljes së tij, kjo gjë nuk ka ndodhur. Situata e krijuar është e tillë që nuk e lejon të vijojë jetën e qetë. Në këto kushte, ajo është larguar me djalin përfundimisht nga banesa ku jetonin së bashku. Duke e menduar si të pakthyeshme situatën e krijuar, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

***Pretendimet e të paditurit.***

I padituri gjatë seancës pajtimore parashtrroi se ato që kishte pretenduar paditësja qëndrojnë. Ai shpjegoi se për të, ajo vazhdon të jetë gruaja e tij dhe nëse dëshironte të kthehej, derën e kishte të hapur. Megjithatë, nëse ajo ishte e vendosur për zgjidhjen e martesës dhe ai nuk kishte kundërshtim.

Referuar objektit të padisë, në zbatim të neneve 6 dhe 155 të Kodit të Familjes, në funksion të vlerësimit të interesit më të lartë të fëmijës, gjykata vendosi kryerjen e një ekspertimi psikologjik. Në këtë kuadër u caktua ekspertja psikologe Marinela Postoli, për të dhënë mendim të specializuar për gjëndjen psikologjike dhe emocionale të fëmijës së mitur si dhe vlerësimin për mënyrën më të përshtatshme të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore.

Meqënëse fëmija i ardhur në jetë nga martesë e palëve ndërgjyqëse është i moshës 13 vjeç, gjykata në referim të nenit 6, 157 të K. Familjes, në seancë gjyqësore realizoi marrjen e mendimit të tij lidhur me faktin se me cilin prej prindërve do të dëshironte të qëndronte. Në këtë seancë, por edhe në seancat e tjera gjyqësore, asistoi edhe psikologjia.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga gjykata, ekspertja përgatiti relacionin e vlerësimit psikologjik me shkrim. Referuar aktit të ekspertimit, psikologjia ndër të tjera ka arritur në përfundimin: "*Lënien e fëmijës së mitur Ergim Terolli për rritje dhe edukim nënës Shkëndie Terolli. Megjithë lidhjen e fortë që fëmija ka me të dy prindërit, kjo është edhe dëshira e tij. Sugjeroj që fëmija të takohet me babain fundjavën e parë, të dytë e të tretë të çdo muaji. Takimet të realizohen nga ditë e premte ora 16:00 deri ditën e dielë ora 12:00. Takimet e fëmijës me babain gjatë pushimeve dimërore nga data 1-5 janar dhe takimet gjatë pushimeve verore 15 ditëshin e parë të muajit gusht. Takimet e fëmijës me babain në ditëlindjen e fëmijës, evente apo festa familjare sipas dëshirës së tyre.*"

Në seancën gjyqësore të diskutimit të aktit psikologjik, përfaqësuesi i paditëses u shpreh se ishte dakord me atë që kishte sugjeruar psikologjia, ndërsa lidhur me masën e detyrimit ushqimor për fëmijën e mitur, sugjeroi shumën 15.000 lekë në muaj.

#### ***Vlerësimi i gjykatës.***

Gjykata pas analizës së faktit të sipërcituar, pretendimeve të palëve dhe referuar parashikimeve ligjore, konkludon se duhet të vendoset zgjidhja e martesës ligjore e lidhur në datën 10.11.2006 midis paditëses Shkëndie Terolli e të paditurit Ermir Terolli.

Në themel të këtij gjykimi qëndron kërkimi për zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve ndërgjyqëse dhe rregullimi i pasojave që vijnë prej saj.

Analiza gjyqësore e kërkimit do të bazohet në dispozitat e Kodit të Familjes që disiplinon martesën, detyrimet lidhur me të, zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj.

#### ***Lidhur me zgjidhjen e martesës.***

Referuar përcaktimeve të nenit 1 të Kodit të Familjes, martesë cilësohet si një shfaqje e vullnetit të dy personave për të krijuar një marrëdhënie juridike të caktuar, nga e cila lindin të drejta dhe detyrime për palët. Nëpërmjet kësaj marrëdhënie bashkëshortët kanë si qëllim kryesor të krijojnë një familje, të jetojnë së bashku dhe të solidarizohen në interesat e njëri-tjetrit. Në momentin që ata nuk kanë më qëllimin për jetesë të përbashkët apo të solidarizohet për mirëqenien materiale, emocionale të njëri tjetrit, të kenë respekt dhe mirëkuptim reciprok, atëherë martesë ka humbur qëllimin e saj kryesor.

Zgjidhja e martesës përbën instrumentin ligjor nëpërmjet të cilit i jepet fund marrëdhënies familjare që buron nga martesë. Ligjvënësi, duke dashur të mbrojë veçanërisht martesën për shkak të natyrës *sui generis* të saj, ka legjitimuar në Kodin e Familjes, neni 123, vetëm tre raste nëpërmjet të cilave mund t'i jepet fund një marrëdhënie të tillë.

Shkaqet e zgjidhjes së martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, janë parashikuar në mënyrë orientuese në nenin 132 të Kodit të Familjes, duke mos përjashtuar dhe shkaqe të tjera, që rast pas rasti mund të paraqiten në marrëdhëniet bashkëshortore që çojnë në bërjen të pamundur të jetesës së përbashkët.

Në rastin konkret, paditësja Shkendie Terolli ka legjitimitet aktiv dhe interes juridik të ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi prej saj varet lindja e të drejtave me karakter personal dhe pasuror, të tilla si: ndryshimi i gjëndjes civile nga e martuar në e shkurorëzuar; e drejta për të lidhur martesë tjetër ligjore, pjesëtimi i pasurisë. Pala e paditur gëzon legjitimitet pasiv, në cilësinë e bashkëshortit të paditëses, me të cilin ka lindur mosmarrëveshja familjare objekt gjykimi.

Në analizë të rrethanave të faktit të provuara gjatë gjykimit, gjykata çmon se martesë e ka humbur qëllimin e saj për paditësen e të paditurin. Në kushtet kur bashkëshortët kanë kohë që nuk kanë marrëdhënie normale me njëri-tjetrin, është e vështirë mbajtja dhe rivendosja e unitetit familjar. Për shkak të grindjeve dhe mosmarrëveshjeve të vazhdueshme paditësja është larguar nga banesa bashkëshortore bashkë me fëmijën e mitur, duke mbetur kështu martesë thjesht formale.

Nga sa më sipër janë shkelur detyrimet që rrjedhin nga martesë, të përcaktuara në nenin 50, 53, 54, 55 të K. Familjes. Gjatë gjykimit rezultoi se këto detyrime nuk janë respektuar, pasi midis palëve ka munguar bashkëpunimi e mirëkuptimi dhe paditësja ka gjetur si zgjidhje ndërprerjen e marrëdhënieve bashkëshortore dhe jetesës së përbashkët. Kjo sjellje ka ndikuar edhe në mos përmbushjen sa e si duhet të detyrimeve që ata kanë ndaj fëmijës.

Në kushtet kur gjykata konkludon për zgjidhjen e martesës, ajo ka detyrimin ligjor të shprehet edhe për zgjidhjen e pasojave që vijnë për bashkëshortët dhe fëmijët.

***Lidhur me pasojat për bashkëshortët, parashikuar në nenet 147-153 të K. Familjes.***

Lidhur me këto pasoja, gjykata, vlerëson se paditësja nuk parashitroi pretendime për kontribut apo për të drejtën e përdorimit të banesës. Gjatë gjykimit nuk rezultoi që palët të kenë banesë në pronësi apo përdorim të përbashkët. Në këto kushte, gjykata çmon se nuk ka vend për t'u shprehur në lidhje me këto të drejta e detyrime të parashikuara në nenet 147-153 të K. Familjes.

Paditësja ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e mbiemrit dhe marrjen e mbiemrit të saj paramartesor. Referuar certifikatës së martesës datë 4.08.2022, rezulton se paditësja ka ndryshuar mbiemrin pas lidhjes së martesës, nga "Lulo", duke marrë mbiemrin e të paditurit, "Terolli". Nga sa më sipër, bazuar në nenin 146 të K. Familjes, në kushtet kur nga e paditura nuk u kërkua mbajtja e mbiemrit pasmartesor lidhur me ndonjë interes të saj apo fëmijës, gjykata çmon se ajo duhet të marrë mbiemrin paramartesor, "Lulo".

***Lidhur me pasojat për fëmijën e mitur, parashikuar në nenet 154-162, 192 e vijues të K. Familjes.***

Neni 215 i K. Familjes parashikon: "Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i

---

*siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij”.*

Në rastin konkret palët kanë një fëmijë të mitur, i cila është i datëlindjes 10.12.2008. Gjykata bazuar në parashikimet ligjore të neneve 154-162, 192 e vijues të K. Familjes ka detyrimin të shprehet lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe kontributin për ushqim që prindërit duhet të japin për fëmijën.

Gjykata, duke mbajtur parasysh, rrethanat e faktit të parashtruara më lart, moshën e fëmijës, mendimin e paraqitur nga ekspertja psikologe nëpërmjet raportit të hartuar, dëshirën e shprehur nga vetë fëmija gjatë pyetjes në seancë gjyqësore, si dhe parashikimet ligjore të neneve 155/1 e 157 të K. Familjes, vlerëson se fëmija, duhet t’i lihet për rritje dhe edukim, nënën. Kjo, për këto arsye:

- Paditësja është kujdesur gjatë gjithë kohës për fëmijën edhe kur palët kanë filluar të jetojnë të veçuar, pavarësisht mbështetjes emocionale dhe materiale që babai i ka dhënë herë pas here.
- Moshë e fëmijës, është e tillë që ka nevojë të vazhdueshme për përkujdesjen e nënës.
- Edhe i padituri ishte dakord për lënien e fëmijës nënën.
- Mendimi i fëmijës, gjatë pyetjes nga gjykata në seancë gjyqësore ishte të qëndronte me nënën, pavarësisht lidhjes që ka me babain. Ai deklaroi se kushtet në banesën ku jeton me nënën i ka më të mira se ato në banesën ku jeton babai.
- Edhe psikologjia, gjatë hartimit të raportit psikologjik, ka sugjeruar këtë zgjidhje.

Gjykata në marrjen e këtij vendimi, ka vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës, referuar parashikimeve të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në zbatim të nenit 6 pika 3 të këtij ligji, për vlerësimin e këtij parimi të rëndësishëm, mbahen parasysh: a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës; d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore”.

Në rastin konkret, nëna i ka mundësitë për të treguar kujdesin e duhur për fëmijën e mitur, pasi është e aftë fizikisht e psikologjikisht. Si gjatë jetesës së përbashkët, por edhe pas veçimit, është kujdesur për djalin dhe nuk rezultoi ndonjë situatë abuzimi apo dhune ndaj tij.

Gjykata duke vlerësuar stadin e moshës në të cilin ndodhet fëmija, çmon se në këtë mënyrë sigurohet më mirë zhvillimi fizik e psikologjik i fëmijës. Gjithashtu, në këtë mënyrë sigurohet dhe vazhdimësia e marrëdhënieve të fëmijës me bashkëmoshatarët në shkollë dhe personat që kanë lidhje gjinore, pasi gjatë kohës që palët jetojnë të veçuara, ai ka qëndruar me nënën.

Ky vendim i gjykatës është gjithashtu edhe në përputhje me parimet e përcaktuara nga nenet 20 e 30 të ligjit 18/2017.

---

Në kushtet kur fëmija i besohet nënës për rritje dhe edukim, babai, në referim të parashikimeve të nenit 158 të K. Familjes, ka të drejtën e mbikqyrjes, takimit, vizitës apo mbajtjes së fëmijës. Gjatë gjykimit, nuk rezultoi ndonjë arsye që dëmton interesin e fëmijës n.q.s. babai ushtron këto të drejta prindërore dhe as ndonjë situatë dhune apo abuzimi. Duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, largësinë e vendbanimit të palëve (banojnë afër njëra-tjetrës) dhe mendimin e psikologes, gjykata çmon që takimet e babait me fëmijën të jenë tre fundjava në muaj. Konkretisht: fundjavën e parë, të dytë dhe të tretë të çdo muaji, nga ora 16:00 e ditës së premte deri në orën 12:00 të ditës së dielë. Takimet e babait me fëmijën gjatë pushimeve dimërore të jenë në periudhën 1-5 janar, ndërsa gjatë pushimeve verore pesëmbëdhjetë ditëshin e parë të muajit gusht.

Me ndryshimin e moshës së fëmijës dhe në qoftë se në të ardhmen palët do të kenë pretendime në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, bazuar në nenin 159 të K.Familjes, mund t'i drejtohen gjykatës, për të kërkuar ndryshimin e vendimit lidhur me këtë disponim.

#### ***Lidhur me detyrimin për kontributin ushqimor ndaj fëmijës.***

Referuar nenit 192/b dhe 197 të K. Familjes, i padituri detyrohet të kontribuojë me detyrimin për ushqim ndaj fëmijës së mitur. Gjatë gjykimit rezultoi se, fëmija nuk ka mjete për jetesë, pasi nuk ka pasuri dhe për shkak të miturisë është i paaftë për punë e nuk mund të sigurojë të ardhura.

Përsa i përket masës së këtij kontributi, gjykata bazuar në parashikimet e neneve 158/1, 201/2 të K. Familjes, mban parasysh nevojat e fëmijës dhe mundësitë që ka secili prind, referuar të ardhurave që siguron.

*Lidhur me nevojat e fëmijës.* Në rastin konkret, fëmija është i moshës 13 vjeç dhe nevojat e tij kanë të bëjnë me ushqyerjen, veshmbathjen, shkollimin dhe argëtimin e tij. Nuk rezultoi që fëmija të ketë probleme shëndetësore që kërkojnë shpenzime të veçanta për kurim. Sipas deklarimeve të palëve gjatë seancës pajtimore, secili prej tyre punon atje ku dhe jetojnë, në Greqi. Nëna vërtet siguron të ardhura nga puna, por e vetme nuk mund të përballojë rritjen dhe edukimin e tij. Nisur nga kostoja e jetesës dhe mosha e fëmijës, gjykata çmon që kontributi i tij të jetë 15.000 lek në muaj. Duke marrë parasysh dhe kontributin e nënës, kjo masë vlerësohet si e përshtatshme për të përballuar nevojat e domosdoshme të fëmijës. Paditësi e ka mundësinë për të dhënë këtë masë kontributi, pasi aktualisht është i punësuar në një mobileri në Athinë; është në gjëndje të mirë shëndetësore dhe në moshë të përshtatshme për të punuar, pasi nuk ngriti ndonjë pretendim për paaftësi fizike për punë; përveç kësaj fëmije, nuk rezultoi të ketë në ngarkim persona të tjerë, ndaj të cilëve detyrohet për kontribut ushqimor apo detyrime të tjera.

Nëse në të ardhmen, gjëndja ekonomike e palëve dhe nevojat e fëmijës do të ndryshojnë, secila palë gëzon të drejtën e rezervuar në nenin 207 të K.Familjes, që të kërkojë ndryshimin e vendimit lidhur me këtë disponim.

#### ***Lidhur me momentin se kur fillon detyrimi për kontributin ushqimor.***

Ky moment është rregulluar nga neni 210/1 i K.Familjes. Referuar parashikimeve të këtij neni, detyrimi për kontribut fillon nga dita e ngritjes së padisë. Në rastin konkret, padia është ngritur në datën 12.09.2022, ditë në të cilën, fillon dhe detyrimi i paditësit.

---

Gjatë gjykimit, palet nuk paraqitën ndonjë dokument për të vërtetuar të ardhurat e tyre, por deklaruan se janë të punësuar në Athinë, atje dhe ku aktualisht jetojnë.

Në këto kushte, përsa më sipër, gjykata çmon se padia është e bazuar në ligj dhe në prova, dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, ato përbëhen nga tarifa mbi aktet 3.000 lekë, shpenzimet për njoftimet në vlerën 260 lekë dhe shpenzimet për shpërblimin e psikologes në vlerën 30.000 lekë, gjithësej 33.260 lekë. Këto shpenzime janë parapaguar nga paditësja. Referuar llojit të gjykimit, gjykata çmon se ato duhet t'i ngarkohen palëve nga ½ pjesë, duke u detyruar i padituri, t'i paguajë paditëses shumën prej 16.630 lekë.

Bazuar në nenet 143 dhe 144 të Kodit të Familjes, pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë, duhet t'i dërgohet për regjistrim Zyrës së Gjendjes Civile, Njesia Administrative Pojan, për të bërë ndyshimet përkatëse në rregjistrë.

Referuar neneve 510 e 511 të K.Pr.Civile, meqënëse ky vendim përmban detyrime konkrete lidhur me të drejtën e takimit të fëmijës dhe kontributin ushqimor për të, ai përbën titull ekzekutiv dhe me ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor.

Referuar nenit 511, shkronja "a" të K.Pr.Civile i ndryshuar, fakti që vendimi përbën titull ekzekutiv, cilësohet në dispozitivin e vendimit të themelit dhe nuk lëshohet urdhër ekzekutimi me vendim të mëvehtshëm.

Referuar nenit 511 paragrafi i dyte i K. Pr. Civile, nuk ka vend për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në lidhje me shpenzimet gjyqësore. Vendimi ekzekutohet drejtpërdrejt nga shërbimi përmbarimor pas njoftimit të tij.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenin 132 e vijues të Kodit të Familjes si dhe në nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile,

### **VENDOSI:**

1. Pranimin e padisë së palës paditëse Shkëndie Terolli.
2. Zgjidhjen e martesës së lidhur në datën 10.11.2006, midis paditëses Shkëndie Terolli dhe të paditurit Ermir Terolli.
3. Pas zgjidhjes së martesës, paditësja Shkëndie merr mbiemrin paramartesor "Lulo".
4. Fëmija i mitur, Ergim Terolli, i datëlindjes 10.12.2008, i lihet për rritje e edukim, paditëses Shkëndie.
5. I padituri Ermir Terolli, ka të drejtën e takimit me fëmijën e mitur Ergim Terolli tre fundjava në muaj. Konkretisht: fundjavën e parë, të dytë dhe të tretë të çdo muaji, nga ora 16:00 e ditës së premte deri në orën 12:00 të ditës së dielë. Takimet e tij me fëmijën gjatë pushimeve dimërore të jenë në periudhën 1-5 janar, ndërsa gjatë pushimeve verore 15 (pesëmbëdhjetë) ditëshin e parë të muajit gusht.
6. Detyrimin e të paditurit Ermir Terolli të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën e mitur Ergim Terolli në shumën 15.000 lekë në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë.

---

7. Shpenzimet gjyqësore iu ngarkohen palëve në mënyrë të barabartë.

8. Një kopje e këtij vendimi, pasi të ketë marrë formë të prerë, t'i dërgohet për regjistrim Zyrës së Gjëndjes Civile, Njesia Administrative Pojan, për të bërë ndryshimet përkatëse.
9. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe me ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbartimor shtetëror ose privat.
10. Kundër këtij vendimi, lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

*U shpall në Korçë, me datë 10.11.2022.*

**SEKRETARE**  
**Brilda HOXHALLARI**



**GJYQTARE**  
**Gentiana SHUKULLARI**

